REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr/Br. 90/17
Data/Datum 31.05.2017
PRISHTINË - PRIŠTINA

Republika e Kosovës

Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

PSH.nr.90/17

PANELI SHQYRTUES I PROKURIMIT PUBLIK, i emëruar nga kryetari në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, në përbërje z. Ekrem Salihu, z. Tefik Sylejmani - Referues, z. Nuhi Paçarizi - Anëtar, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga operatori ekonomik NTP"Ballkan Petroll"-Ferizaj, kundër njoftimit për dhënie të kontratës lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Furnizim me vajra dhe yndyra (lubrifikant për makineritë e minierës" me nr. prok. 12997/12998/17/433/121, iniciuar nga AK-/Trepça-Ndërmarrje nën administrimi të AKP-së/ më datën 23.05.2017 mori këtë:

V E N D I M

I. **Refuzohet** , si e **pabazuar** ankesa e operatorit ekonomik "NTP"Ballkan Petroll"-Ferizaj, lidhur me aktivitetin e prokurimit "Furnizim me vajra dhe yndyra (lubrifikant për makineritë e minierës" me nr. prok. 12997/12998/17/433/121, iniciuar nga AK-/Trepça- Ndërmarrje nën administrimi të AKP-së/

II. **Vertetohet ,** vendimi për anulim AK-së /Trepça- Ndërmarrje nën administrimi të AKP-së/ lidhur me aktivitetin të prokurimit, me titull: "Furnizim me vajra dhe yndyra (lubrifikant për makineritë e minierës" me nr. prok. 12997/12998/17/433/121,

III. Autoriteti Kontraktues në aftë prej **10** ditësh duhet ta informoj me shkrim Panelin Shqyrtues për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit .

IV. Mos respektimi i këtij vendimi, detyron Panelin shqyrtues që konform dispozitave ligjore të nenit 23.9 dhe 131 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, të ndërmarr masa ndaj Autoritetit Kontraktues , që nuk respekton vendimin e Panelit Shqyrtues të paraparë me ketë ligj;

V. Me qenë se ankesa e operatorit ekonomik ankues "NTP"Ballkan Petroll"-Ferizaj refuzohet si e pa bazuar, i konfiskohet tarifa e ankesës konform nenit 33.5 në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës.

A R S Y E T I M

Njoftimi për kontratë në lidhje me këtë aktivitet të prokurimit është bërë me dt:24.02.2017

Hapja e ofertave është bërë me dt:09.03.2017, ku kanë marr pjesë tre operator ekonomik.

Njoftimi për dhënie të kontratës lidhur me ketë aktivitetit të prokurimit është bërë me dt:15.03.2017, ku është rekomanduar për kontratë operatori ekonomik NTP "SNR" Hajrushi"-Prishtinë.

Kundër njoftimit për dhënie të kontratës të aktivitetit të prokurimit, operatori ekonomik "NTP"Ballkan Petrol"-Ferizaj me dt: 22.03.2017, ka bërë kërkesë për rishqyrtim tek autoriteti kontraktues.

Me dt: 27.03.2017 autoriteti kontraktues ka marr vendim që të refuzohet kërkesa për rishqyrtim e operatorit ekonomik, "NTP"Ballkan Petrol"-Ferizaj

Operatori ekonomik ankues "NTP"Ballkan Petrol"-Ferizaj si palë e pa kënaqur, ka deponuar ankesë në OSHP, me 30 Mars 2017 me nr. 90/17 kundër njoftimit për dhënie te kontratës, lidhur me aktivitetin e prokurimit "Furnizim me vajra dhe yndyra (lubrifikant për makineritë e minierës" me nr. prok. 12997/12998/17/433/121, të zhvilluar nga Autoriteti Kontraktues AK-/Trepça- Ndërmarrje nën administrimi të AKP-së/ duke pretenduar se autoriteti kontraktues, lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, ka bërë shkelje të këtyre dispozitave të LPP-së.

- *Neni 1 i LPP-së,(Qëllimi i ligjit).*
- *Neni 7 i LPP-së (Barazia në Trajtim/Jo-Diskriminimi).*

- *Neni 28 i LPP-së, (Specifikimet Teknike).*
- *Neni 59 i LPP-së (Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve).*
- *Neni 69 i LPP-së (Aftësitë Teknike dhe/ose profesionale)*

Organi Shqyrtues i Prokurimit, konform nenit 113 dhe 114 të LPP-së me datë 06.04.2017 ka autorizuar ekspertin shqyrtues, për të shqyrtuar vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palës ankimore.

Eksperti Shqyrtues në raportin e dt: 13.04.2017, duke u mbështetur në vlerësimet e lartë cekura, i rekomandon panelit shqyrtues që të REFUZOJ si të pa-bazuar ankesën OE "Ballkan Petrol", me seli në Ferizaj, për këtë aktivitet të prokurimit dhe njëherit të APROVOJ vendimin e Autoritetit kontraktues "Njoftimi për dhënien e kontratës, i datës 15.03.2017, me titull: Furnizim me vajra dhe yndyra (lubrifikant për makineritë e minierës)", me nr. prokurimi: 12997/12998/17/433/121, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Trepça-Ndërmarrje në Administrim të AKP-së..

Autoriteti kontraktues përmes parashtresës me shkrim të datë: 14.04.2017, ka njoftuar Panelin shqyrtues se pajtohet me raportin e ekspertit shqyrtues

Operatori ekonomik ankues përmes parashtresës me shkrim të datë: 14.04.2017, me anë të parashtresës, ka njoftuar OSHP-në, se nuk pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Në seancën e shqyrtimit kryesor të datës 23.15.2016,të mbajtur pa pranin e palëve konform nenit 26 paragrafi 1 të rregullores së punës së OSHP-së kanë qenë prezent anëtarët e panelit shqyrtues, eksperti shqyrtues, ku u shqyrtuan shkresat e lëndës duke e bërë kontrollimin dhe analizimin e dokumentacionit për procedurën e prokurimit i cili përbëhet nga: autorizimi i inicimit të aktivitetit të prokurimit, njoftimi për kontratë, procesverbali mbi hapjen e ofertave, vendimi mbi themelimin e komisionit të vlerësimit të ofertave raporti i vlerësimit të ofertave, ankesa e operatorit ekonomik, raporti i ekspertit të OSHP-së, parashtresat e palëve në procedurë.

Gjatë prezantimit në seancë ekspert shqyrtues ka deklaruar; siç kam konstatuar dhe rekomanduar ne raportin e ekspertizës se datës 13.04.2017, i rekomandoj panelit shqyrtues qe ta refuzoj si te pa bazuar ankesën e OE ankues , si dhe ta aprovoj vendimin e AK-se lidhur me kete aktivitet te prokurimit. Për gjitha pretendimet ankimore i gjeni ne raportin e dt 13.04.2017

Në fjalën përfundimtar eksperti shqyrtuese deklaroj; qëndroj në tërësi pranë raportit të ekspertizës, si dhe pranë konstatimeve dhe rekomandimeve të dhëna në raportin e datës 13.04.2017

Në lidhje me pretendimin ankimor sa i përket shkeljes se nenit 59 të LPP-së, konkretisht kriteret e kërkuar në FDT dhe njoftimin për kontrat, se OE. i rekomanduar për kontrat NUK ka plotësuar kriteret e FDT-së, specifikimin teknik si dhe ka ofruar çertifikat të kualitetit ISO 9001 dhe çertifikaten e mjedisit ISO14001, me afat të skaduar , paneli shqyrtues bazuar në kërkesat e dosjes së tenderit dhe njoftimit për kontrat si dhe rekomandimin e ekspertit shqyrtues vlerëson se pretendimi ankimor është i pabazuar për faktin se në dosjen e tenderit dhe njoftimit për kontrat NUK është kërkuar fare certifikata e kualitetit ISO 9001 dhe çertifikaten e mjedisit ISO14001, edhe pse të njëjtat dukemente gjinden në ofertën e OE të rekomanduar për kontrat,

Paneli shqyrtues vlerëson se komisioni vlerësues gjatë vlerësimit, ekzaminimit të ofertave për këtë aktivitet të prokurimit ka vepruar në harmoni me nenin 59.4 e LPP-së si dhe nenin 41.1 të UOPP, duke përdoret gjate vlerësimit vetëm kriteret e matshme të cilat paraprakisht janë vendosur në dosjen e tenderit dhe njoftimin për kontrat, si kritere të kualifikimit.

Në lidhje me pretendimin ankimor te OE.ankues sa i përket shkeljes se nenit 28 dhe 69 të LPP-së, konkretisht specifikimit teknike Aneks 1, lidhur me mos përmbushjen e këtij specifikimi teknik nga ana e OE të rekomanduar për kontrat, Paneli shqyrtues bazuar në kërkesat e dosjes së tenderit si dhe rekomandimin dhe konstatimin e eskpertit shqyrtues , vlerëson se pretendimi ankimor është i pabazuar për faktin se në dosjen e tenderit aneks 1, janë kërkuar karakteristikat e produktit (vajrave) si dhe të posedojn ATESTET VALIDE, që ka të bëjë me implementimin e kontratës dhe të njëjtat specifikime NUK mund të përdoren në fazë e vlerësimit pasi që NUK është kërkuar katalogu siç pretendon OE ankues por janë kërkuar vetëm ATESTET për këto produkte që ka të bëjë me liferimin e mallit. Eksperti shqyrtues vlerëson se mbetet përgjegjësi e Autoritetit kontraktues që gjatë implementimit të kontrates të ketë parasysh kërkesat e FDT, specifimin teknike Aneks 1, në lidhje me karakteristik e produktit që të implementoj në përputhshmëri kontraten sipas specifikimit teknik të kërkuar në FDT.

Paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP-së, si dhe duke u bazuar në provat e prezantuara si më lart vendosi që t'ia fal besimin raportit të ekspertit shqyrtues të dt.13.04.2017 dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

KSHILLA JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative për kompensim dëmi ne afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të vendimit.

Kryesuesi i Panelit Shqyrtues

Z. Ekrem SALIHU

Vendimi t'i dorëzohet:

1x1 AK -"Trepça- Ndërmarrje nën administrimi të AKP-së"

1x1 OE NTP"Ballkan Petroll"-Ferizaj"

1x1 Arkivës së OSHP-së;

1x1 Për publikim në web- faqe të OSHP-së.